



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr.62/2016

Prishtinë, më 21.6.2016, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL
I Mbledhjes së Komisionit për Zhvillim Ekonomik,
Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Sasha Milosavljeviç, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Fatmir Rexhepi Blerim Grainca dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Glauk Konjufca, Pal Lekaj dhe Enver Hoti, anëtarë.

I ftuar: Naser Osmani, kryetar i Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Pjesëmarrës të tjerë: Dardan Abazi, INDEP; Agnesa Haxhiu, KDI; Arta Rexha, Rrokum /TV; Drilon Asllani, RTD; Dibran Istrefi, Klan Kosova; Ismail Shabani, “Kosova Press” dhe Sinisha Kostiq, RTK2.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina dhe Donika Lushaku, praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 14 dhe 16.6.2016;
3. Harmonizimi i qëndrimeve me Komisionin për Buxhet dhe Financa, lidhur amendamentin 32 të Projektligjit nr. 05/L-079 për Investimet strategjike në Republikën e Kosovës;
4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit nr.05/L-088 për Rregullat e Komunikacionit Rrugor;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit, propozoi që për pikën: “4.Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit për Rregullat e Komunikacionit Rrugor”, të ndryshohet dhe të bëhet: “Raportimi i grupit të punës për Projektligjin për Rregullat e Komunikacionit Rrugor”, pasi që ende grupi i punës nuk ka arritur ta përfundojë shqyrtimin e projektligjit.

Rendi i ditës u miratua me propozimin e kryetarit.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 14 dhe 16.6.2016

Procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 14 dhe 16.6.2016, u miratuan pa vërejtje.

3. Harmonizimi i qëndrimeve me Komisionin për Buxhet dhe Financa, lidhur amendamentin 32 të Projektligjit nr. 05/L-079 për Investimet strategjike në Republikën e Kosovës

Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit, tha se siç e dimë, ka pasur dy propozim-amendamente nga Komisioni funksional dhe Komisioni i përhershëm për Buxhet dhe Financa, dhe sipas konkluzionit të seancës plenare, gjatë shqyrtimit të raportit me amendamente, në lexim të dytë, na është rekomanduar që neve, si dy komisione, t'i harmonizojmë këto dy amendamente dhe Komisioni funksional e ka propozuar amendamentin 32 neni 22, ndryshohet si vijon:

Neni 22

Bartja e të drejtës së shfrytëzimit të pronës së paluajtshme publike dhe shoqërore tek investitori i interesuar

1. Qeveria e Republikës së Kosovës mund të bartë të drejtën e shfrytëzimit të një prone të paluajtshme shoqërore për investime strategjike në bazë të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme, vetëm pasi Kuvendi i Republikës së Kosovës të marrë vendim me shumicë të thjeshtë votash.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës mund të bartë të drejtën e shfrytëzimit të një prone të paluajtshme publike, përkatësisht komunale për investime strategjike, vetëm pas vendimit me shumicë të thjeshtë të votave të Kuvendit të Republikës së Kosovës, përkatësisht Kuvendit të Komunës përkatëse.

Fatmir Rexhepi, tha se ky amendament e ka një peshë të veçantë për Komisionin tonë dhe për Komisionin për Buxhet dhe Financa, i cili do ta marrë në shqyrtim këtë propozim. Z. Rexhepi, theksoi se propozimi i mëhershëm ka qenë me 61 vota për, pra që të merret vendim për shpronësimin e pronave të paluajtshme, i cili ka qenë me vend, ndërsa tani propozimi që të merret vendim me shumicë të thjeshtë votash, nuk është legjitim të kalojë me 31 vota një pasuri shoqërore ose publike. Ai tha se Kuvendi i Kosovës duhet të marrë vendim me shumicën e

votës së deputetëve, pra me 61 vota dhe jo të jetë me shumicë të thjeshtë, pasi që po vendosim për një çështje të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të vendit.

Besim Beqaj, tha se ky projektligj nuk është ai që e kemi menduar më herët dhe se nuk përcakton qartësisht hapjen e rrugës në formë funksionale për investime strategjike. Z. Beqaj, tha se nga mbledhja e Kuvendit në seancën plenare, është parë që kemi divergjenca në një çështje që është thelbësore, ndërsa sa i përket shumicës së nevojshme për të kaluar vendimi për shpronësim të pronave të paluajtshme për investime strategjike në Kuvend, më legjitim dhe do të ishte më mirë me 61 vota, por Qeveria e ka paraparë këtë forum, që vendimi mund të merret edhe me shumicën e thjeshtë. Andaj, i kam rezervat e mia lidhur me këtë mënyrë të vendosjes, mirëpo nuk do të jemi pengesë dhe në parim jam pro kalimit të projektligjit me këto amendamente.

Blerim Grainca, personalisht e përkrah idenë që projektligji të miratohet, por tha se ka pasur vërejtje lidhur me koston e lartë financiare, ndërsa sa i përket amendamentit 32 dhe projektligjit në tërësi, janë disa paqartësi se si do të pajtohen për çmimin e vlerës dhe cilat do të jenë kriteret për shpronësim të pronave, të cilat në Projektligjin për investimet strategjike, nuk janë caktuar, p.sh. nëse i marrim pronat e ndërmarrjeve shoqërore, se me cilin kriter dhe kusht do të shpronësohen pronat e paluajtshme. Prandaj, ne duhet të ndryshojmë një pako të ligjeve, siç është Ligji i AKP-së dhe i shpronësimit.

Naser Osmani, tha se meqenëse doli një konstatim nga seanca plenare, se duhet të harmonizohemi me amendamentin 32 të nenit 22, që konsideroj se është amendamenti kyç në të gjithë këtë projektligj dhe propozimi që është ofruar tani nga Komisioni funksional i plotëson shumicën e kërkesave që dolën nga Qeveria. Z. Osmani, theksoi se e respektojnë amendamentin e Komisionit funksional, por nga përvoja e ime, kemi të bëjmë me disa lloje të pronave që administrohen nga komunat, Agjencinë e Pyjeve dhe pronën shoqërore që administrohet nga AKP-ja, duke përjashtuar pronën private, prandaj çështja e shpronësimit nuk është aq e lehtë, sepse të gjitha këto prona i kanë specifikat veta. Ai tha se prona që administrohet nga AKP-ja, këtu duhet të jemi shumë të kujdesshëm, sepse nëse një aset i jepet një investitori të jashtëm, atëherë në bazë të Ligjit të AKP-së, duhet t'u jepet 20%- shi punëtorëve të ndërmarrjes shoqërore, që është obligim se në cilën shumë do të paguhet dhe është goxha vështirë për të ditur se cilat janë obligimet e kreditorëve dhe furnitorëve, cila është kjo shumë që duhet të paguhet, nëse të gjitha këto obligime kalojnë në Qeveri, duhet pasur parasysh, që të jemi shumë të kujdesshëm që vlera e obligimeve të mos jetë më madhe se investimi. Andaj, për çdo gjë duhet pasur një arsye ekonomike dhe një vlerësim. Ne, si deputetë, duhet të vendosim mbi bazën e interesit të përgjithshëm publik, duhet respektuar Ligjin për shpronësime, që nuk është aspak i lehtë të zbatohet në këtë rast dhe Ligjin e AKP-së, që duhet të plotësohet dhe të ndryshohet, si dhe t'i përshtatet Ligjit për investime strategjike dhe vendimit të Kuvendit.

Raif Qela, tha se lidhur me amendamentin 32 të nenit 22, i kam rezervat e mia për variantin e propozuar, ku merret vendim me shumicë të thjeshtë votash. Ai theksoi se me më legjitim do të ishte sikur të shkohet me propozimin e marrjes së vendimit për shpronësime me shumicën e të gjithë deputetëve, pra me 61 vota për, por nëse shkohet me propozimin prej 31 votave, me shumicën e thjeshtë për marrjen e një vendi të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendit, ka gjasa të mos jetë aq legjitim. Z. Qela, tha se në parim do jem pro këtij amendamenti, pasi që

për këtë çështje kemi diskutuar gjatë, në mënyrë që mos të jemi pengesë e mosmiratimit të Projektligjit për investime strategjike, do të votoj për.

Besim Beqaj, tha interesi për investime është që kalimi i pronave të kalojë nëpërmes Kuvendit dhe jo përmes Qeverisë, sepse nëse ky vendim mbetet të merret në Qeveri dhe nëse ndërrohet Qeveria, atëherë vendimi mund të revokohet, ndërsa nëse kalon në Kuvend vendimi është më legjitim dhe nuk mund të revokohet, prandaj ky është një aspekt i cili e bën investitorin më të sigurt që të investojë dhe procesi është më transparent.

Sala Berisha-Shala, tha se po shihet që ka dilema lidhur me amendamentin 32, por qëllimi i përgjithshëm i Projektligjit për investime strategjike është që të joshën investitorët dhe nuk duhet të paragjykohet legjitimiteti i marrjes së vendimit se me sa vota mund të merret vendimi për shpronësim të pronës. Prandaj, duhet që ky projektligji të reflektojë edhe me ligjet e tjera, siç është Ligji për shpronësime dhe për AKP-në.

Fatmir Rexhepi, theksoi se propozimi që amendamenti 32 i nenit 22, që vendimi të merret me shumicën e thjeshtë të votave në Kuvend, nuk është aspak legjitim, ndërsa nëse shkohet me propozimin që të merret vendim me shumicën e të gjithë deputetëve të tij, pra me 61 vota për, ky vendim do të ishte më legjitim dhe do t'ia jepte një përmbajtje tjetër vendimit që do të shtojë rëndësinë e investimeve strategjike dhe do t'ua rrisë peshën edhe vetë investitorëve. Ai shtoi se edhe Ligji për buxhetin, nuk duhet të kalojë me shumicën e thjeshtë, por me shumicën e të gjithë deputetëve të Kuvendit, sepse është ligj i rëndësishëm, mandej kemi ligje që kalojnë të 2/3 e Kuvendit, pra kemi praktikë dhe mund të jetë edhe ky një ligj i tillë, që të kalojë me 61 vota për.

Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit, theksoi se e kupton drejt arsyetimin e kolegëve deputetë, por kjo është një çështje vitale dhe e kemi gjetur një zgjedhje optimale për këtë çështje. Ndërsa, propozimi që Kuvendi të marrë vendim për shpronësimin e pronave me shumicën e të gjithë deputetëve të tij, mund ta implikojë marrjen e vendimit për investitorin strategjik. Z. Mustafa, theksoi se gjatë gjithë shqyrtimit të projektligjit dhe në grupin e punës, ka pasur transparencë me palët e interesit dhe nëpër komisionet parlamentare. Ai, në fund, kërkoi që të bëhet një rregullim teknik në amendamentit 9, ku në vend të tekstit “nënparagrafit 2.1 dhe 2.7” të thuhet “sipas paragrafit 2”.

Propozimi u përkrah nga Komisioni.

Pas debatit, Komisioni me 7 (shtatë) vota për dhe 1 (një) kundër, nxori këtë

Përfundim

1. Miratohet Raporti me rekomandime i Projektligjit nr.05/L-079 për Investimet strategjike në Republikën e Kosovës;

2. Raporti me rekomandime t'i procedohet Kuvendit për lexim të dytë.

4. Raportimi i grupit të punës për Projektligjin nr. 05/L-088 për Rregullat e Komunikacionit Rrugor

Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit, tha se lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, mund të na njoftojë z. Raif Qela, që është kryesues i grupit të punës për Projektligjin për Rregullat e Komunikacionit Rrugor.

Raif Qela, në cilësinë e kryesuesit të grupit të punës të Projektligjit për Rregullat e Komunikacionit Rrugor, theksoi se grupi i punës ende nuk e ka përfunduar shqyrtimin e të gjitha neneve në tërësi, deri më tani grupi i punës ka mbajtur 6 mbledhje dhe ka organizuar një 1 punëtori dhe 1 dëgjim publik dhe kemi arritur të kemi 150 (njëqind e pesëdhjetë). Pasi që, ky projektligj ka gjithsej 264 (dyqind e gjashtëdhjetë e katër) nene, tha se problemet në këtë projektligj janë kryesisht teknike e gjuhësorë, që po na marrin shumë kohë në korrigjimin e tyre. Z. Qela, tha se përveç këtyre problemeve, duhet të pritët, derisa të miratohet edhe Projektligji për Kundërvajtje, që është në shqyrtim nga Komisioni për Legjislacion, në mënyrë që Projektligji për Rregullat e Komunikacionit Rrugor, të harmonizohet me këtë projektligj.

Kryetari propozoi që shqyrtimi i Raportit me amendamente të Projektligjit për Rregullat e Komunikacionit Rrugor, të jetë në mbledhjen e radhës.

Propozimi u përkrah nga Komisioni.

4. Të ndryshme Çështjet vijuese.

Mbledhja përfundoi në orën 10:15.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa